

QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
INSTITUTI I GJUHËSISË DHE LETËRSISË

**SHQIPJA NË ETAPËN E SOTME:
POLTIKAT E PËRMIRËSIMIT
DHE TË PASURIMIT TË STANDARDIT**

(Aktet e konferencës shkencore – Durrës, 15-17 dhjetor 2010)

BOTIMET ALBANOLOGJIKE
Tiranë, 2011

Qendra e Studimeve Albanologjike
Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë

PASQYRA E LËNDËS

Aktet e konferencës shkencore
SHQIPJA NË ETAPËN E SOTME:

POLITIKAT E PËRMIRËSIMIT DHE TË PASURIMIT TË STANDARDIT

Përgatitën për botim:

Akad. Koleç Topalli

Prof. dr. Ludmilla Buxheji

Dr. Anila Çepani

Adelina Çerpja

Ilirian Martiri

Faqosi: Dr. Anila Çepani

Kopertina: Dorina Muka

Nën kujdesin e Prof. Dr. Ardian Marashi

ISBN 978-9928-4095-6-0

© Copyright: Qendra e Studimeve Albanologjike, 2011.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Botimet Albanologjike

Shtypur në shtypshkronjën "KRISTALINA-KH"

HAPJA E KONFERENCËS SHKENCORE 1

ARDIAN MARASHI

SHQIPJA NË ETAPËN E SOTME: SFIDAT E GJUHËS DHE TË GJUHËTARËVE 1

SEANCA I: HISTORIA E FORMIMIT TË STANDARDIT. STANDARDI DHE

LEGISLACIONI 1

BAHRI BECI

NJË PERIODIZIM NDRYSHË I HISTORISË SË STANDARDIZIMIT TË SHQIPES 1

REXHEP ISMAILI

POLITIKA (E MUNGUAR) E GJUHËS 3

SEIT MANSAKU

NGA GIUHA LETRARE KOMBËTARE TE GIUHA STANDARDE - DALLIME

TERMINOLOGJIKE DHE PËRMBATËSORE 5

BARDHËI DEMIRAJ

NORMA GJUHËSORE DHE SUBSTANDARDI NË NJË TEKST SHQIP TË SHEK.

XVIII NË AREALIN KULTUROR TË VERIUT 6

BAHTIAR KRËZIU

SHQIPJA MES GLOBALIZIMIT DHE VARIANTIZIMIT 8

RRAHMAN PAÇARIZI

RRUGA E ZHVILLIMIT TË SHQIPES STANDARDE NË RAPORT ME NEVOJA E

KOMUNIKIMIT 5

DISKUTIME RRETH REFERATEVE, KUMTESAVE DHE TEMATIKËS SË SEANCËS I 11

SEANCA II: PROBLEME GRAMATIKORE TË STANDARDIT 12

ETHEM LIKAJ

MORFOLOGJIA E SHQIPES STANDARDE DHE ZHVILLIME TË REJA 12

WILFRIED FIEDLER

TENDENCAT E FORMIMIT TË SHUMËSIT NË SHQIPEN E SOTME 14

BESIM BOKSHI

RRETH PROBLEMIT TË PASKALORES NË GJUHËN SHQIPE 15

ARTAN HAXHI - TOMOR OSMANI

FORMA TË SHUMËSIT NË RRAFSHIN E PLANIFIKIMIT GJUHËSOR TË

SHQIPES 16

ANILA OMARI

VËSHTRIM MBI DISA PRIRJE TË GJUHËS SË SOTME LETRARE 17

SHKUMBIN MUNISHI	
MBI MUNDËSINË E INTEGRIMIT TË PASKALORES NË GJUHËN STANDARD	
SHQIPE	195
MIMOZA KARAGJOZI-KORE	
PËR NË PËRMIRËSIM TË NORMËS MORFOLOGJIKE NË STANDARD	205
JULIE MAY KOLJINI	
MUNDËSIA E PËRDORIMIT TË PASKALORES NË STANDARDIN E GJUHËS	
SHQIPE	217
DISKUTIME RRETH REFERATEVE, KUMTESAVE DHE TEMATIKËS SË SEANCËS II	235
SEANCA III: PROBLEME TË DREJTSHKRIMIT DHE TË PASURIMIT	
TË STANDARDIT	243
KOLEC TOPALLI	
DREJTSHKRIMI I SHQIPES SI SISTEM	245
MEHMET ELEZI	
STANDARDI I NGJIRË PËRBALLË GJUHËS SË LIRË	309
MEHMET ÇELIKU	
PËR NË PËRMIRËSIM TË MËTEJSHËM TË SHQIPES STANDARDE: MBI	
NDRYSHIMIN E DISA RREGULLAVE TË "DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS	
SHQIPE" (1973)	329
AUJUA JUBANI-BENGU	
RREGULLAT E DREJTSHKRIMIT TË SHQIPES STANDARDE DHE DISA	
TRAJTESA TË DISKUTUESHME	339
LUDMILLA BUXHELI	
ÇËSHITJE TË SHKRIMIT TË FJALËVE TË PËRNGJITURA DHE TË DISA	
STRUKTURAVE ANALITIKE	347
HASAN MUJAJ	
ZBATIMI I GJUHËS STANDARDE NË INSTITUCIONET SHETËRORE	
TË KOSOVËS	363
BESIM KABASHI	
PASURIMI DHE PËRMIRËSIMI I STANDARDIT TË GJUHËS VËSHTRUAR	
NGA PIKËPAMJA E PËRPUIMIT TEKNOLOGJIK TË GJUHËVE NATËRORE	
SOT	371
DISKUTIME RRETH REFERATEVE, KUMTESAVE DHE TEMATIKËS SË SEANCËS III	385
SEANCA IV: MARRËDHËNIET E STANDARDIT ME DIALEKTET. NORMA	
LEKSIKORE	397
DAVID LUKA	
A MUND TË ZGJEROHET BAZA DIALEKTORE E SHQIPES STANDARDE?	399
ARDIAN VEHRIU	
LEKSIKU I SHQIPES SË SOTME - SFIDA TË PASURIMIT	441

ARDIAN KLOSI	
EQREM ÇABË DHE LEHTËSIMI I SHQIPES SË SHKRUAR	44
JORGJI GJINARI	
MARRËDHËNIET E SOTME TË DIALEKTEVE ME GJUHËN LETRARE	45
FERDINAND LENA	
FJALË DHE SHPREHJE TË HUADA TË PANEVOJSHME	46
ASLAN HAMITI – AITEN QAMILI	
SHTRIRJA DIALEKTORE E FJALËS DHE PËRZGJEDHJA E FORMËS	
NORMATIVE	47
AGRON DURO - VILMA PROKO	
PROBLEME TË STANDARDIT NË TERMINOLOGJI	48
MUSTAFA IBRAHIMI	
SHTRESIMET QË NDIKONË NË VARIANTET E GJUHËS STANDARDE	
SI DUKURI SOCIOJINGUISTIKE	50
ÇIRIM BIDOLLARI	
STANDARDI DHE ONOMASTIKA - NDËRRIME, NDRYSHIME APO VETËM	
STANDARDIZIM?	51
DISKUTIME RRETH REFERATEVE, KUMTESAVE DHE TEMATIKËS SË SEANCËS IV	52
SEANCA V: STANDARDI DHE NORMA LETRARE (LETËRSIA, SHKOLLA, MEDIAT)	53
VALTER MEMISHA	
STANDARDI DHE LETËRSIA ARTISTIKE	53
IMRI BADALLAJ	
SA DHE SI REALIZOHET SHQIPIA STANDARDE NË SHKOLLË DHE NË	
UNIVERSITET	55
AU LASHARI	
SHQIPIA NË "SHTRATIN E PROKRUSTIT" DHE PËRDORIMI I SHQIPES	
STANDARDE NË TEKSTET SHKOLLORE	56
BARDH RUGOVA	
GIUHA E GAZETAVE TË KOSOVËS	57
TOMORR PLANGARICA	
MBI DISA TREGUES TË ASPEKTTIT "NORMATIV" NË MËSIMDHËNIEN	
E SOTME TË GJUHËS SHQIPE	58
LINDITË SEIDU-RUGOVA - BLERTË ISMAILI	
PROBLEMATIKA E TEKSTEVE SHKOLLORE NË TË MËSUARIT E SHQIPES	
NË KOSOVË	59
ABDULLA BALLHYSA	
PËRVETËSIMI I RIKONCEPTUAR I STANDARDIT NË SHKOLLËN SHQIPTARE	60
HAXHI SHABANI	
PROBLEMET E MËSIMIT DHE TË PASURIMIT TË STANDARDIT	61

LEDI SHAMKU-SHKREU

NEOSTANDARDI I SHQIPES – TRADITË DHE PËRTRIMJE..... 625

DISKUTIME RRETH REFERATEVE, KUMTESAVE DHE TEMATIKËS SË SEANCËS V 635

DISKUTIM I PËRGJITHSHËM 645

PËRFUNDIMET E KONFERENCËS 657

BESIM KABASHI

PASURIMI DHE PËRMIRËSIMI I STANDARDIT VËSHTRUAR NGA PIKËPAMJA E PËRPUNIMIT TEKNOLOGJIK TË GJUHËVE NATYRORE SOT

Një gjuhë natyrore kodifikon të gjitha gjërat që i rrethojnë folësit e saj dhe me ndryshime shoqërore, kulturore, politike, ekonomike, shkencore e kështu, me radhë, ndryshon edhe ajo. Si shembull mund të përmenden fjalët *internet* dhe *e-mail*, të cilat para disa vitesh paktësi i dinte. Fjalët e reja, të krijuara brenda vetë gjuhës apo të huazuara, në shumë raste sjellin a ndërtojnë një përdorim të veçantë, p.sh. në fushën e valencës, dhe në këtë mënyrë ndryshojnë gjuhën në formë të ndryshme. Në disa raste fjalët ose strukturat gramatikore në përdorim pësojnë ndryshime të tjera, bie fjala, ndryshime kupitimi, ndërsa disa fjalë dalin nga përdorimi. Kështu, gjuha ndryshon vazhdimisht.

Në këtë shkrim trajtohen teorikisht dhe shkurtimisht çështje që lidhen me planifikimin gjuhësor dhe me përpunimin teknologjik të gjuhëve natyrore. Zhvillimi i resurseve gjuhësore, parë si pasurim i standardit, ka peshën më të madhe në këtë shkrim.

1. Standardi

Gjuha si mjet komunikimi, si instrument i jetës shoqërore përdoret në shumë relacione, në shumë situata dhe ka shumë veçor sidomos në kohët moderne, ku jeta e njerëzve po bëhet gjithnjë e më ndërlikuar. Që gjuha të jetë sa më përfshirëse për tri mbuluar këu veçori, ajo do duhet përkujdesje gjithnjë e më të madhe nga folësit apo nga të interesuarit e tjerë për të, një lloj rregullimi i cili sot njihet, ndë të tjera, edhe me emërtimin *planifikim gjuhësor*.¹ Një prodhim

¹ Për më tepër rreth planifikimit gjuhësor kës. [HAUGEN 1987] dhe [OMDAL 2006] Këtu do të trajtohen vetëm pikat e planifikimit gjuhësor të cilat kanë të bëjnë me përpunimin teknologjik të gjuhëve natyrore, më saktësisht vetëm resurset gjuhësore

planifikimit gjuhësor, një ndër më të rëndësishmit, është standardi i gjuhës apo quajtur ndryshe norma gjuhësore. Ky emërtim përdoret për një kod gjuhësor, d. m. th. materialin gjuhësor me rregullat përcaktuese dhe përskruese të tij, i cili detyrohet nga shteti ose përdoret me vetëdëshirë në shkolla dhe administratë me qëllim komunikimin e njësuar, të folur dhe të shkruar, për hapësirën (mbikrahinore, mbarështetërore ose më gjerë) për të cilën është caktuar përdorimi dhe po ashtu për të gjitha grupet e shtresat shoqërore. Ai duhet të kuptohet plotësisht dhe të jetë lehtësisht i përdorshëm si në shqiptim, në përzgjedhje fjalësh, në ndërtim fjalish dhe në formë shprehjeje. Kujdes i madh i kushtohet standardit në fushën e arsimit, përmes të cilit ai mësohet, kultivohet, ndërmjetësohet dhe kontrollohet më mirë – drejshqiptimi, drejshkrimi, gramatika dhe stili përbëjnë fushat kryesore.²

Për standardin, i cili funksion kryesor ka kontrollin mbi gjuhën e komunikimit, modernizimi³ i tij është detyrë e vazhdueshme, qoftë ai edhe një thjeshtëzim drejshkrimi, siç është rasti i gjermanishtes, apo edhe modernizim në kuptimin e procesit të zhvillimit, bie fjala në fushën e leksikografisë, p.sh. përcaktimi i terminologjisë së ruajtjes së mjedisit⁴. Varësisht nga nevojat shoqërore dhe nga ato të vetë shtetit apo shteteve, si bartës të standardit, përcaktohen përparësitë dhe fushat e modernizimit.

Pasurimi, trajtuar si çështje që lidhet me planifikimin gjuhësor, mund të përcaktohet si një veprim, ndërmarrje ose ndërhyrje përmes së cilës nuk bëhen ndryshime të asaj që ekziston, p.sh. ndryshim

Ato mund të shihen si çështje në përberje të pikave 2 dhe 4 (Corpus Planning) nga HAUGEN [1987 : 627].

² Lexuesi i interesuar mund të lexojë veprën “klasike” për standardizimin e shqipes [BYRON 1976]. Këtë çështje e ka trajtuar edhe BREU [1997].

³ Ndër studues të tjerë të kësaj teme le të khs. këtu [JACOBSON 2006].

⁴ Reforma e drejshkrimit të gjermanishtes kishte për qëllim rishikimin e drejshkrimit të fjalëve të huazuara, të shkronjës “ß” dhe përcaktimin e rasteve kur fjalët “e përbera” shkruhen ndaras përkatësisht bashkë.

rregullash, por një zgjerim. Një shembull do të ishte zhvillimi terminologjisë në fusha të ndryshme, bie fjala, nga fusha teknologjisë së informacionit⁵. Pranimi i mbikëqyrtur i material gjuhësor nga dialektet, i cili ka prirje të përhapjes dhe i cili tregojë rritje përdorimi, apo edhe i materialit gjuhësor nga tradita letrare d ishte pasurim standardi. Me *përmirësim* të standardit, trajtuar po ashtu si çështje që lidhet me planifikimin gjuhësor, bëhen ndryshime të normës në rrafshet e ndryshme me qëllim të përmirësimit të lëshimeve të evidentuara në standard, thjeshtëzimit të rregullave të ndryshme apo përshtatjes së tyre⁶. *Norma* është më shumë se drejshkrimi edhe pas ajo shpesh kuptohet ose barazohet me drejshkrimin. Le të kujtohet këtu shenjat e pikësimit, topologjia e fjalëve në fjalë, stili, e. k. m. r. Ajo shtrihet në disa rrafshet: në atë fonetik, grafemor, morfologjik sintaksor, stilistik tekstor e në rrafshet tjera. Një shembull nga pikëpanja grafemore do të ishte moszëvendësimi i shkronjave “Ë/ë” dhe “Ç/ç” me “E/e” dhe “C/c”, pra respektimi i normës drejshkrimore, ndërsa nga stili një shembull do të ishte të komunikuarit me “Ju/ju” përkatësisht me “Ti/ti” dhe drejtpërdorimi i trajtave të tyre. Përdorimi pasurimi mund të bëhet pa u vërejtur (shumë), proces, i cili nuk sjell ndryshime të gjërave ekzistuese, përmirësimi, varësisht nga shkalla apo masa është një *reformë* dhe si e tillë sjell me vete ndryshimet e përmendura. Në shumë raste bëhet një ndryshim jo i vogël, i cili prek veçoritë kryesore të gjuhës.

2. Kultivimi i gjuhës dhe përpunimi teknologjik i saj

Zhvillimet në gjuhë kanë nevojë për një kontrollim dhe sistemin në harmoni me ligjet e saj, pra duhet një kultivim i mëtutjeshëm i saj.

⁵ Le të krahasohet këtu drejshkrimi i fjalëve të huazuara si *e-mail*, e cila fjalë është shkurtësë nga *electronic mail*, anglisht për *postë elektronike*.

⁶ Kjo çështje mund të shihet në përberje të pikave 1 dhe 3 (Status Planning) nga HAUGEN [1987 : 627].

⁷ Shkurtesë për “e kështu me radhë” – një propozim për pasurim.

Në këtë kupim një ndër çështjet thelbësore që lidhen me planifikimin gjuhësor janë edhe *resurset gjuhësore*, khs. pikën 2.1. Standardizimi i tyre dhe përdorimi i tyre krahas rolit tradicional edhe për qëllime teknologjike përbën një temë që do një vëmendje më të madhe në të ardhmen, khs. pikat 2.2 dhe 2.3. Kultivimi i gjuhës dhe ndërtimi i resurseve apo përkujdesja për to duhet të jetë një proces i pandërprerë dhe si i tillë ndërlidhet me përshtatje dhe ndryshime të tyre, khs. pikën 2.4. Terminologjia, khs. pikën 2.5, është një temë që do përkujdesje të theksuar. Pastaj, resurset dialektore duhen parë si pjesë e pandarë e gjuhës dhe duhet të trajtohen pa paragjykimë, khs. pikën 2.6. Kultura gjuhësore, khs. pikën 2.7, është një temë që po ashtu kërkon përkujdesje të shtuar, sidomos për kohën e tashme të ndryshimeve të mëdha dhe të shpejta. Së fundi, në lidhje me diskutimet për përmirësimin e mundshëm të standardit, reforma drejtshkrimore e gjermanishtes është një shembull i mirë krahasimi në këtë fushë, khs. pikën 2.8. Këto tema së bashku përbëjnë këndet e një kornize, e cila ngërthen gjërat më thelbësore që në një mënyrë ose në një tjetër theksojnë lidhjen në mes të gjuhës dhe teknologjisë së përpunimit të gjuhëve, situatën në të cilën ndodhet gjuha dhe diskutimet për të të formës “si të shkohet tujtje”.

2.1 Resurset gjuhësore mund të përkufizohen si material gjuhësor fonetik, leksikor, morfologjik, sintaksor, semantic e. k. m. r., material tjetër i mundshëm, së bashku me informacionin për të, i cili është i përgatitur në një formë që të mund të përdoret për qëllime të caktuara, bie fjala, për qëllime mësimore ose shkencore. Fjalorët e ndryshëm, gramatikat e ndryshme apo edhe korpuset e gjuhës (së folur dhe të shkruar) janë shembuj tipikë. Resurset gjuhësore në njërin anë mund të dokumentojnë gjuhën dhe në anën tjetër mund të shërbëjnë për kultivimin e saj si rrefyes përdorimi, pra ato mund të kenë rol edhe deskriptiv edhe preskriptiv.

Pa resurse nuk mund të ketë analizë dhe prodhim automatik të

suksesshëm të gjuhëve natyrore, si rrjedhojë nuk mund të ketë zhvillim cilësor të produkteve të kësaj fushë; bie fjala, nuk ka program të mirë drejtshkrimor pa një fjalor të tillë të mirë dhe rregulla të qartë eptimi⁸ dhe fjalëformimi. Resurset jociësore, si bazë e një program kompjuterik për *përpunimin teknologjik të gjuhëve natyrore* (n vazhdim *p. l. gj. n.*), mund të dëmojnë apo edhe të tjetërsojnë tekstin përkatësisht gjuhën, gjatë përpunimit automatik. Për këtë arsye resurset gjuhësore duhet të kodifikohen saktësisht dhe me përpikëri. Materiali gjuhësor duhet të jetë i plotë, i koleksionuar, i seleksionua dhe i analizuar, bie fjala për klasifikimin e foljeve ai duhet të jetë në formën: “klasa k_x e foljeve [me veçoritë: $v_1, v_2, \dots, v_{n-1}, v_n$] ka f folj [dhe ato janë: $f_1, f_2, \dots, f_{n-1}, f_n$].”⁹ Resurset duhet po ashtu të jenë të standardizuara – në nivel kombëtar, dhe sa i përket formatit të tyre nevojitet edhe koordinim ndërkombëtar¹⁰.

Është për t'u theksuar edhe se në disa fusha mungojnë resurse thelbësore, bie fjala, për gjuhën shqipe nuk ekziston një fjalor i cili përcakton ndarjen në rrokje apo një tjetër që përcakton shqiptimin çdo fjale, gjë që do t'i hynë në punë secilit – në të vërtetë kjo do t' duhej jo vetëm për trajtën përfaqësuese të një fjale (në fjalor), por për të gjitha trajtat e një fjale, sidomos për p. l. gj. n.¹¹

2.2 Përmes standardeve bëhet i mundur një përkufizim i saktë veçorive të dijes dhe gjërave tjera, si p.sh. atyre teknike, në mënyrë që atyre t'u referohet cilido apo që ato të përdoren nga secili në çfarëdi situatë, pa u ngatërruar. Një shembull i thjeshtë është alfabeti i një

⁸ Khs. këtu p. sh. rregullat e eptimit në veprën [1989] nga MEMUSHAJ.

⁹ Ato duhet të jenë të *gjitha të renditura*. FIALORI [1976] është një shembull për sa përket përkufizimit të secilit fjalë me një rregull/ligj të caktuar. Rreth nevojës për krijimin e një korpusi, khs. këtu diskutimin nga KABASHI [2009].

¹⁰ Kjo temë nuk do të preket këtu për t'u lënë për një shqyrtim të veçantë, khs. p. sh [GIBBON et al. 1997] dhe [RAPPÉL et al. 2005].

gjuhë, i cili, kuptohet, për gjuhët e zhvilluara është i standardizuar: të gjithë mund t'i referohen atij standardi dhe ta përdorin atë si të tillë pa llogaritur shmangie, ndryshime, pagatësi apo gjëra të tjera të paparashikueshme, khs. edhe projektin *Unicode*¹², i cili ka si qëllim të përkufizojë të gjitha shenjat dhe alfabetet e mundshme qartë si një sistem dhe në një vend. Një shembull tjetër do të ishte Alfabeti Fonetik Ndërkombëtar (International Phonetic Alphabet).

2.3 Një ndër fushat ku resurset gjuhësore kanë filluar të përdoren, së pari, është përkthimi gjysëmautomatik apo automatik. Kohëve të fundit ato përdoren gjithnjë e më shumë si ndihmë gjatë të shkruarit apo të mësuarit për nevoja të ndryshme. Të kërkuara po bëhen resurset gjuhësore edhe në fusha të rëndësishme, bie fjala, në spitale, për shërbime teknologjike, të cilat përdorin gjuhën si mjet komunikimi, p.sh. për gjenerimin automatik të një raporti mjekësor apo edhe për t'i ofruar mundësinë një pacienti që ai vetë, sipas dëshirës, t'i lexojë, përkatësisht dëgjojë, në gjuhë natyrore nga një aparat mjekësor rezultatet e testimeve të ndryshme të gjendjes së tij shëndetësore. Po ashtu, dita-ditës po rritet interesimi për shërbimet e ndryshme, në veçanti për të moshuarit, bie fjala, për kontrollim përmes gjuhës natyrore të pajisjeve shtëpiake, p.sh. të dritave. Për t'i realizuar shërbimet e tilla duhen, ndër të tjera, resurse gjuhësore nga ato të drejtshkrimnit dhe drejtshqiptimit, deri te ato të dialogjive. Resurse gjuhësore do t'i duheshin edhe një makine kompjuterike në një stacion autobusi, e cila do të kishite, ndër të tjera, aftësinë për të dhënë sqarime (me shkrim apo me zë), bie fjala, se përse është vonuar autobusi i linjës x apo edhe për t'ia thënë njeriut, në raste të tilla, rrugën më të shkurtër a më të lehtë deri te stacioni tjetër më i afërm, me qëllim

¹¹ Një krahasimi i mirë do të ishte gjermanishtja, drejtshkrimi i së cilës nuk ndryshon shumë nga ai i shqipës. Khs. këtu edhe fjalorët [CELEX 1995], [AUSSPRACHE 2005] dhe [RECHTSCHREIBUNG 2009] për gjermanishten.

¹² Për më shumë informacione shih. adresën www.unicode.org.

mberrijen tij sa më shpejt në cakun e dëshiruar – një gjë, e cil teknikisht tanimë është realitet. Sistemet ndihmuese për navigim gjat ngarjes së automjeteve ose të përllogarrijës së rrugës janë një shembull (më) i thjeshtë i së njëjtës fushë.

2.4 Për të bërë një planifikim të mirë duhet një monitorim vazhdueshëm dhe i gjithanshëm i fenomeneve gjuhësore. Nga t dhënat e tilla mund të bëhen parashikimet e ardhshme për periudha t ndryshme kohore. Një monitorim gjuhë, sidomos përmes të dhënave të nxjerra nga korpuset, është një domosdoshmëri për të shqyrtua zhvillimin e gjuhës jo vetëm nga ana introspektive edhe nga ajo empirike, p.sh. për të nxjerrë prirjet apo vlerën e veçorive të standardi në fusha të ndryshme, vëshirësitë në përdorimin e tij apo edhe pikat dobëta të mundshme të tij. Një metri të tillë, d. m. th. majte t shumanshme për fenomenet gjuhësore e ofron p. t. gj. n.

Me ndryshimet në gjuhë, me proceset natyrore të saj planifikuesit e gjuhës në raste të dhëna marrin vendime për ndërhyrj në standard, me qëllim që ta përshtatin atë me rrethanat e reja. Në këtë rast, ndryshimi, p.sh. i drejtshkrimnit, detyron përtëritjen (aktualizimin e të gjitha gjërave të cilat kanë të bëjnë me gjuhën: shkollat administrative publike, ligjet, përkthimet e ndryshme, e. k. m. r. Edh resurset dhe sistemet elektronike të përpunimit të gjuhës preken ng një ndryshim i tillë.

Vështruar nga pikëpamja e përpunimit teknologjik të gjuhëve natyrore, pasurimi dhe përmirësimi i standardit apo çdo ndërhyrji duhet të jetë e planifikuar mirë, e bërë nga njohësit e fushave përkatëse dhe nga këndvështrimi ndërfaqësor. Në një mënyrë tjetër ndërhyrja do të ishte më e kushtueshme. Çmimi varet nga zhvillim ekonomik përkatësisht nga përhapja e teknologjive që përdori gjuhën, përkatësisht resurset gjuhësore. Pas çdo ndërhyrjeje duhe llogaritur një fazë kalimtare të paktën dhjetëvjeçare.

2.5 Një tjetër temë e rëndësishme e cila do shqyrtim serioz është

terminologjia¹³. Ndër të tjera edhe në mungesë apo pamjaftueshmëri të personelit të kualifikuar për të mbuluar zhvillimet shkencore, shoqërore-politike e kulturore me literaturë të caktuar, në disa raste vërehet një zhvillim i pakontrolluar, amator e joprofesional në fushën e terminologjisë. Një shembull janë të ashtuquajturat lokalizime, d. m. th. përkthime, të ndryshme në fushën e programeve kompjuterike. Bie fjala, përkthimi *përditësim* [khs. FIALOR 2006] i frëngji. *ajourner* qëndron për dikë që përcjell shtypin çdo ditë dhe është i mirinformuar, por jo në fushën e përpunimit të informacionit, sidomos jo për fushat ku informacioni ndryshon shumë shpesh ose pandërprerë, të paktën disa herë në ditë. Në këtë kuptim, në vend të fjalës *përditësim* do të duhej të përdreshin fjalët *përrëritje*, (*ritjefreskim* ose *aktualizim*, të cilat i përgjigjen më mirë kuptimit të fjalës angleze *update* (angl. to bring sth. up to date [angl. *date* = *datë*, jo *ditë*]). Një agjenci lajmesh, p.sh., aktualizon fagen e saj të internetit çdo disa minuta. A do të duhej të quhej kjo përditësim i asaj faqeje? Sigurisht jo!¹⁴ Jo vetëm në fushën e informatikës, por edhe në shumë fusha tjera sociale dhe teknologjike duhet një terminologji e përrëritë, e aktualizuar apo edhe e ndërtuar për të parën herë. Pas zhvillimeve sociale e teknologjike globale, duke shtuar edhe tranzicionin shoqëror e politik të hapësirës shqipfolëse, do të duhej që terminologjia të përcaktohej nga njohës dhe përgjegjës të fushave përkatëse dhe të standardizohet. Jo rralle njëri shërbehet me terminologji angleze, tjetri me franceze, i treti me gjermane, e i katërti me atë italiane, në mungesë të asaj shqipe.

2.6 Për bërijen e resurseve pasuria dialektore është e një rëndësie

¹³ Khs. në lidhje me këtë temë edhe trajtimin nga studiuesit DURO dhe PROKO në këtë përmbledhje punimesh.

¹⁴ Khs. *Kjo faqe përrëritet (aktualizohet) çdo pesë minuta* vs. **Kjo faqe përditësohet çdo pesë minuta*.

të madhe.¹⁵ Ajo mund të përdoret pa cenuar standardin dhe në shërbim të tij. Gjatë një përpunimi automatik, p.sh., ndonjë fjalë apo shprehje, pa ose me dashje, mund të jetë dialektore – e cila edhe si e tillë duhet të analizohet. Në këtë kuptim resurset dialektore nuk duhen lënë pas dore – ato duhen pa dyshim edhe pa pasur vlerë normative.¹⁶

2.7 Jo rralle, veçanërisht në media, prodhohen fjali të pakuptimita dhe gramatikisht jokorrekte, ndeshen stile të cilat nuk i përshatën tipit të tekstit dhe përmbajtjes së tij, pra nuk janë në përputhshmëri me rregullat normative. Një analizë e tyre është shpesh e pamundshme. Këtë problem do ta zbushte deri në një nivel të pranuar një kulturë e mirë gjuhësore, e cila do të mbante nën kontroll prodhimin e gjuhës sipas rregullave të saj natyrore dhe normative. Cilësia e arsimit ndikor

¹⁵ Bie fjala, pasuria dialektore e mbledhur për një kohë të gjatë nga Instituti Gjuhësisë dhe i Letërsisë (Tiranë) do të duhej të përpunohet, të digjitalizohet dhe t'vihen në shërbim lexuesit, shkruarit – të gjithë të interesuarve dhe të ndërtohet s' resurs elektronik gjuhësor. Një shembull në këtë kuptim është [ATLAS DIALEKTOLLOGJIK 2007/2008].

¹⁶ Në shumë raste emërtimet përbëjnë një përfjashim kur bëhet fjalë për standardin ndonëse edhe ato duhet normuar në "një formë të lehtë". Bie fjala, emërtime gjeografike lihen në formën e tyre sa më natyrale të mundshme, d. m. th. në format: *lyre* që i njëjtë popullsisia lokale. Dy a më shumë vende me emra në formën dialektor nuk ngatërrohen, edhe nëse ata kanë prejardhje nga e njëjta fjalë, ndërsa në aspektin kulturor e historik përbëjnë një pasuri, khs. këtu edhe trajtimet e kësaj çështjeje ng studiuesit TOPALLI dhe BIDOLLARI në këtë përmbledhje punimesh. Si shembull krahasimi mund të merren emërtimet në Gjermaninë Jugore dhe në Zvicër të Veriperëndimore, d. m. th. gjermanishtfolëse, ku p. sh. emra vendesh kan prejardhje nga e njëjta fjalë, por janë zhvilluar ndryshe nga njëri-tjetri dhe sot kan forma të ndryshme, bie fjala, njëri ka veçoritë fonetike e ortografike para procesit i monofongjimit përkatësisht difongjimit, tjetri pas këtyre proceseve. Edhe emra sidomos ata familjarë, d. m. th. mbietnat, duhen trajtuar po ashtu në mënyrë i veçantë. Një ndër fushat që përbën një vështirësi të madhe gjatë p. t. gj. n. janë edhe emrat. Këto resurse, të cilat shpesh nuk përfillen, janë ndër më të kushtueshme Fjalortë e shqipes do të duhej të përmbanin edhe emra përkatësisht në shumë të tili kur dihet se në gjuhën shqipe ata lakohen dhe kanë kategori gramatikore, të cilat nu kuptohen vetvetiu apo lehtë. Kjo është shumë e nevojshme në rastet e prodhimit i gjuhës.

drejtpërdrejt në kulturën gjuhësore: arsim më cilësor do të thotë kulturë gjuhësore më cilësore. Një shembull mosrespektimi rregullash normative e logjike janë titujt e gazetave, të cilët kanë, bie fjala, pikësim jashtë çdo norme. Një i tillë do të ishte "Ullinjtë, sa janë të kënaqur bujqit?", ku në vend të *presjes* do të duhej të ishin *dy pika*, khs. këtu veprën [PKËSIMI: 82 v. (§ 133)].

2.8 Reforma e drejshkimit të gjermanishtes ka marrë më shumë se dhjetë vite kohë, ka qenë shumë e kushuteshme në aspektin ekonomik, dhe ndonëse zyrtarisht e fuqizuar dhe e përfunduar, pasojat e saj ende ndihen. Përkrahësit e reformës, e cila është rishqyrtuar dhe ndryshuar disa herë gjatë viteve të kaluara, nuk kishin parashikuar aq shumë probleme, sa i nxori koha. Edhe aspektet teknike ishin parashikuar si të papërfillshme, por realiteti tregon të kundërtën.

Planifikuesit e shqipes do të mund të shmangnin shumë gjëra të padëshiruara, ndër të tjera dhe një çmim të lartë financiar, duke mësuar nga përvoja gjermane, duke shqyrtuar mirë raset e diskutueshme para një ndërhyrjeje të mundshme. Pos që do të duhej të planifikohet mirë, ato do të duhej të jetësoheshin përmjetërësh, me qëllim që të shmangeshin ndërhyrjet e shpeshta, khs. versionet e reformës drejshkrimore të gjuhës gjermane (1996, 2004 dhe 2006).¹⁷

Përmbledhje

Çdo ndërhyrje në standard, goftë ajo pasurim apo përmirësim, mund të realizohet nga pikëpamja teknologjike. Sa më të përhapura të jenë teknologjitë në fjalë (ndër të tjera edhe në kuptimin sasior dhe të varësisë së përdoruesve nga to), aq më i lartë do të ishte çmimi i

¹⁷ Khs. [RECHTSCHREIBUNG 2009]. Shkrimi ndryshe në kuptimin ndaras apo bashkë i dy apo më shumë njërive morfemore, p. sh. në raste të ndryshme të fjalëformimit, pas një reforme të mundshme sjell ndryshime të ndjeshme, me këtë edhe vështirësi për një kohë, khs. këtu [EGER 2010] për një përilogaritje të ndryshimeve pas reformës drejshkrimore të gjermanishtes.

aktualizimit të programeve kompjuterike (për secilin përdorues veç e veç, por edhe çmimi i përgjithshëm në ekonominë kombëtare).

Për një përmirësim të mundshëm përkatësisht për një reformë të mundshme, do të ishte e logjiksme të thuhet: sa më pak ndryshime, aq më e lehtë do të ishte për përshtatjen e resurseve ekzistuese. Pasurimi i standardit është i nevojshëm dhe duhet të jetë i vazhdueshëm, ndërsa përmirësimi varet nga nevoja e shoqërisë dhe interesi i caktuar për atë veprim. Në rastin e dhënë standardi do të duhej të përmirësohet duke iu shtruar një vlerësimi shkencor. Shpenzimet financiare do të ishin më të vogla nëse përmirësimet do të ishin të pranuar shkencërisht në masë të gjerë nga studiuesit, në mënyrë që pas një përmirësimi të mos kishite nevojë për korrigjime a përmirësimë të tjera pas një kohe të shkurtrë. Pa u kthyer në një proces destandardizimi, standardi do të duhej të pasurohet, nëse është e domosdoshme dhe të përmirësohet me qëllim që të plotësojë sa më mirë funksionin e tij.

Për përpunimin teknologjik të gjuhëve natyrore duhen resurse përkatëse cilësore. Duke përshkruar qartë gjuhën dhe caktuar qartë rregullat funksionale dhe veçori të saj në formë resurcesh do të pasurohet standardi.

Literatura / Referencat

- [AMMON et al. 1987] Ulrich Ammon / Norbert Dittmar / Klaus J. Mattheier (Editors): *Sociolinguistics*. 1st Edition. Vol. 1. Berlin / Neë York: Ëalter de Gruyter, 1987.
- [AMMON et al. 2006] Ulrich Ammon / Norbert Dittmar / Klaus J. Mattheier / Peter Trudgill (Editors): *Sociolinguistics*. 2nd Edition. Vol. 3. Berlin / Neë York: Ëalter de Gruyter, 2006.
- [ATLASI DIALEKTOLOGJIK 2007/2008] Jorgji Gjinari / Bahri Beci / Giovailin Shkurtaaj / Xheladin Gosturani etj. *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Universitë degji Studi di Napoli

- L'Orientale, Dipartimento di Studi dell'Europa Orientale. Vellimi I, 2007 / Vellimi II, 2008.
- [AUSSPRACHE 2005] Duden – *Das Ausspracheörterbuch*. 6. Auflage. Mannheim / Leipzig / Wien, Zürich : Dudenverlag, 2005.
- [BREU 1988] Eäter Breu : „Variantenstreit und Normierung im Albanischen“. 237–258. [In :] Klaus J. Mattheler : *Standardisierung und Destandardisierung europäischer Nationalsprachen*. Frankfurt am Main : Lang, 1997.
- [BYRON 1976] Janet L. Byron : *Selection among Alternates in Language Standardization : The Case of Albanian*. The Hague / Paris : Mouton, 1976.
- [CELEX 1995] Linguistic Data Consortium : *The celex Lexical Database*. Release 2. Nijmegen : Centre for Lexical Information, 1995.
- [EGER 2010] Steffen Eger : „Investigating lexical competition – An Empirical Case Study of the German Spelling Reform of 1996/2004/2006“. 3–21 [In :] *Journal for Language Technology and Computational Linguistics* [JLCL] 25 (1) / 2010.
- [FJALOR 1976] Androkli Kostallari / Mahir Domi / Emil Lafa / Nikoleta Cikuli : *Fjalor drejshkrimor i gjuhës shqipe*. Tiranë : Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, 1976.
- [FJALOR 2006] Jani Thomai / Migo Samara / Pavli Haxhillazi / Hajri Shehu / Thanas Feka / Valter Memisha / Artan Goga : *Fjalor i gjuhës shqipe*. Tiranë : Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2006.
- [GIBBON et al. 1997] Dafydd Gibbon / Roger Moore / Richard Eïnsk (Editors) : *Handbook of standards and resources for spoken language systems*. Berlin / Neë York : Eäter de Gruyter, 1997.
- [HAUGEN 1987] Einar Haugen : „Language Planning“. 626–637 (§ 74) [In :] [AMMON et al. 1987].
- [JACOBSON 2006] Rodolfo Jacobson : „Language Planning : Modernization“. 2421–2431 (§ 243). [In :] [AMMON et al. 2006].
- [KABASHI 2009] Besim Kabashi : „Resurset e gjuhës shqipe – një diskutim rreth gjendjes së tyre të tashme“. 97–102. [In :] (Aktet nga *Seminari III i Albanologjisë*. Tetovë, Universiteti Shtetëror i Tetovës, 2009.

- [MEMUSHAJ 1989] Rami Memushaj : *Morfologji e eptimit të gjuhës së shtetërisht shqipe*. Tiranë : Shtëpia Botuese e Librit Universitar 1989.
- [OMDAL 2006] Helge Omdal : „Language Planning : Standardization“ 2384–2394 (§ 241). [In :] [AMMON et al. 2006].
- [PIKËSIMI 2002] Mahir Domi / Menella Totoni / Nikoleta Cikuli / Spir Floqi / Mariana Ymeri / Ludmila Buxheli : Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë *Rregullat e pikësimit në gjuhën shqipe*. Tiranë : Shkencë, 2002.
- [RECHTSCHREIBUNG 2009] Duden – Die Rechtschreibung. 25. Auflage. Mannheim / Leipzig / Wien, Zürich : Dudenverlag, 2009.
- [TRIPPEL et al. 2005] Thorsten Trippel / Thierry Declerck / Ulrich Heid : „Sprachressourcen in der Standardisierung“. 17–29. [In :] *Journal for Language Technology and Computational Linguistics* [JLCL] 20 (2) / 2005.